

VENDIM
Nr.577, datë 5.9.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.463, DATË 5.7.2006 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR
ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integritimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull, pas fjalëve “...Stabilizim-Asociimit” të shtohen “...2007-2012”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2007-2012, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave, të raportojnë pranë Ministrisë së Integritimit, në fillim të çdo muaji, për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sipas metodologjisë së hartuar nga kjo Ministri. Grupi ndërministror i punës për shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e punës, për zbatimin e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, vlerëson dhe analizon, periodikisht, zbatimin e këtij plani.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha